FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 32

Tiranë – E martë, 10 mars 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 11/2020 datë 12.2.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar.....	2793
Ligj nr. 13/2020 datë 12.2.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar.....	2795
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 28.2.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 21, datë 25.11.2010 "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore"…….....	2798
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 6, datë 4.3.2020	Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë.....	2799
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 78, datë 4.3.2020	Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", miratuar me vendimin nr. 64, datë 15.4.2019, të KLP-së.....	2806
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 120, datë 5.3.2020	Për miratimin e "Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit"....	2806
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 126, datë 6.3.2020	Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.2.2019.....	2824
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2551, datë 6.3.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte në fshatin Mbrakull", Poliçan.....	2824

Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Petroshi..... 2825

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ymer Qafa..... 2825

LIGJ
Nr. 11/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8561, DATË 22.12.1999, "PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË, PRONË PRIVATE, PËR INTERES PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 41, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët "ministrit kompetent sipas këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kur shpronësimi është kryer me kërkesën e një subjekti juridik privat, ministri përgjegjës për zhvillimin urban i kërkon Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH) që, mbi kërkesën paraprake të këtij subjekti, të bëjë kalimin e pronësisë së pasurive të shpronësuara nga shteti në favor të subjektit privat që ka kërkuar shpronësimin, me kushtin që të jetë vërtetuar sipas ligjit realizimi i ndërtimit ose i investimit për interes publik, për të cilin është kryer shpronësimi.".

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në rastet kur pronari ka vdekur ose është shpallur i zhdukur dhe nuk është lëshuar dëshmia e trashëgimisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin ose subjektet e interesuara për shpronësimin kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil dhe në ligjin për noterinë, në rast se kërkesa nuk është paraqitur ose refuzohet të paraqitet nga subjektet e interesuara.".

2. Në pikat 2, 3 dhe 5, emërtimi "ministri/a kompetent/e" zëvendësohet me emërtimin "Agjencia Shtetërore për Shpronësimin".

Neni 3

Neni 7 riformulohet si më poshtë:

"Neni 7
Objekte të shpronësimit

Objekte të shpronësimit janë pasuritë e paluajtshme në formën e tokës, të ndërtimeve të çdo lloji, me karakter të përhershëm, pasuritë e luajtshme të treguara në shkronjat "e" dhe "ë", të nenit 8, të këtij ligji, kulturat bujqësore, si dhe çdo investim tjetër i trupëzuar në tokën bujqësore, që do të shpronësohet.".

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja "ë" riformulohet si më poshtë:

"ë) Për rastet kur objekte të luajtshme e të paluajtshme, për shkaqe objektive, në kushtet e degradimit ose forcës madhore, krijojnë rrezik të përhershëm për sigurinë dhe shëndetin publik ose krijojnë rreziqe për zhvillimin e qëndrueshëm, në atë shkallë që me gjithë ndihmën e shtetit, këto rreziqe nuk mund të parandalohen nga pronari i tyre.".

2. Pas shkronjës "f" shtohet shkronja "g" me këtë përmbajtje:

"g) Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.".

Neni 5

Në nenet 10, pika 1; 11, pika 2; 12, pikat 1, 2 e 3; 13, pikat 1 e 2; 14, pika 1; 15, pikat 1, 2 dhe 3; 16, pikat 2, 3, 4 e 5; 17, pika 1; 22 dhe 24, pika 1, emërtimi "ministria", "ministri/a/në kompetente" zëvendësohet me emërtimin "Agjencia/në Shtetërore për Shpronësimin".

Neni 6

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

"Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kërkesa për shpronësim paraqitet në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim bëhet nga ministri përgjegjës për zhvillimin urban.".

3. Pas pikës 4 shtohen pika 5 e 6 me këtë përmbajtje:

"5. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin është institucion në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, e cila, përveç detyrave të tjera të përcaktuara në këtë ligj, kryen edhe detyrat e mëposhtme:

a) planifikon dhe trajton kërkesat për shpronësim nga institucionet përkatëse;

b) përllogarit masën e shpronësimit për çdo pronë të prekur nga shpronësimi;

c) mbikëqyr ecurinë e procesit të shpronësimeve;

ç) krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi;

d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë.".

Neni 7

Në nenin 15, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin njëkohësisht me njoftimin e kërkesës për shpronësim për interes publik, sipas pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, për të krijuar mundësinë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të personave të tretë ndaj ose për shkak të pasurisë, pronë private, që kërkohet të shpronësohet, bën publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ASHSH-së.".

Neni 8

Në nenin 17 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohen fjalët "dhe llojin e shpërblimit".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Masa e shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen për interes publik, për realizimin e projekteve dhe të investimeve në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, llogaritet në përputhje me parashikimet e marrëveshjes, në rastet kur atje përcaktohet edhe mënyra e përllogaritjes së masës së shpërblimit.".

Neni 9

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19
Llogaritja dhe lloji i shpërblimit

1. Mbi bazën e vlerës që rezulton nga vlerësimi përfundimtar i objekteve që shpronësohen, përllogaritet masa e shpërblimit përkatës, në masë të njëjtë me vlerën e plotë të tij.

2. Përjashtimisht kompensimit në vlerë, sipas parashikimeve në këtë ligj, shpërblimi mund të bëhet dhe në natyrë për rastet dhe sipas rregullave që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 10

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20
Propozimi për shpronësim

1. Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

a) Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit e të përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilin citohen edhe dokumentet që kërkohen në shkronjat "a" deri në "dh", të nenit 10, të këtij ligji.

b) Listën përfundimtare të pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen ose që zhvlerësohen, e cila përmban edhe të dhënat identifikuese për aktet përkatëse kadastrale, si dhe listën e personave të tretë, të drejtat e të cilëve duhet të kompensohen për shkak të shpronësimit.

c) Dokumentacionin që citon bazën ligjore përkatëse për vlerësimin e pasurive që shpronësohen e zhvlerësohen, e të drejtave të të tretëve që lidhen me to, dhe të masës së shpërblimit apo kompensimit të propozuar.

2. Ministri, në rast se dokumentacioni i paraqitur në pikën 1, të këtij neni, është i plotë, dërgon në Këshillin e Ministrave projektvendimin për miratimin e shpronësimit.".

Neni 11

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Regjistrimi i ri i pasurive të shpronësuara

Pasuritë pronë private, të shpronësuara, duhet të regjistrohen sipas ligjit. Ky regjistrim duhet të kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin.".

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 12

Procedurat e shpronësimit, të nisura përpara ngritjes së Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, do të vijojnë të kryhen nga ministritë kompetente, sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në çastin e nisjes së procedurave.

Neni 13

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për zhvillimin urban që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 6, të këtij ligji.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 12.2.2020.

LIGJ
NR. 13/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 108/2013, "PËR TË HUAJT", TË NDRYSHUAR1

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2004/38/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, "Mbi të drejtën e shtetasve të Bashkimit Europian dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht brenda territorit të shteteve anëtare", që ndryshon Rregulloren (KEE) dhe shfuqizon direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE, të ndryshuar. Numri CELEX 32004L0038, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 158, datë 30.4.2004, faqe 77–123.

Neni 1

Në nenin 3, pika 32 ndryshohet si më poshtë:

"32. 'Vizë' është autorizimi në formën e një vize pullë në një dokument të vlefshëm udhëtimi ose vizë elektronike, e printuar nga format elektronik, lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, sipas procedurave të këtij ligji, që lejon të huajin të hyjë, të qëndrojë ose të kalojë tranzit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

Neni 2

Në nenin 21, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Viza e tipit 'C' është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar nga format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë, brenda 180 ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.".

Neni 3

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Viza e tipit 'D' është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar nga format elektronik për shtetasin e huaj që kërkon të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë, brenda 180 ditëve, dhe kur, për t'u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë.".

2. Në pikën 5, pas fjalëve "vizës pullë" shtohen fjalët "dhe vizës elektronike".

Neni 4

Në nenin 24 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "jashtë vendit," shtohen fjalët "nëpërmjet sistemit elektronik të vizave,".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Për të aplikuar për vizë, shtetasi i huaj paraqitet personalisht në konsullatë ose aplikon *online* në sistemin elektronik të vizave.".

3. Pika 5 shfuqizohet.

4. Në pikën 6, fjalia e dytë shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 25 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohen fjalët "ose duke printuar vizën elektronike të miratuar.".

2. Në pikën 2, pas fjalëve "Lëshimi i vizës" shtohen fjalët "pullë dhe vizës elektronike" dhe emërtimi "Ministria e Punëve të Jashtme" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për punët e jashtme".

Neni 6

Në nenin 28, në titull dhe në përmbajtje, pas fjalës "viza/vizës" shtohen, përkatësisht fjalët "pullë dhe elektronike", me përjashtim të pikës 3.

Në pikën 5, emërtimi "Ministria e Punëve të Jashtme" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për punët e jashtme".

Neni 7

Në nenin 29, në titull dhe në përmbajtje, pas fjalës "viza/vizës/vizën", shtohen, përkatësisht, fjalët "pullë dhe elektronike".

Neni 8

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët "dhe 60 ditë" zëvendësohen me fjalët "dhe brenda 60 ditëve".

2. Në pikën 3, fjalët "brenda 60 ditëve" zëvendësohen me fjalët "brenda 30 ditëve".

Neni 9

Në nenin 71 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3, pas fjalëve "me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë" shtohen fjalët "pavarësisht motivit të qëndrimit".

2. Pika 4 shfuqizohet.

3. Në pikën 5, fjalët "30 ditëve" zëvendësohen me fjalët "10 ditëve pune".

4. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"9. Përjashtohen nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, dhe gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit e të vetëpunësimit, sipas parashikimeve të Kodit të Punës:

a) shtetasit e vendeve të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së shtetasve të njërit prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;

b) shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;

c) të huajt që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore.".

Neni 10

Në nenin 72 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "a", pas fjalëve "shtetas të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen" shtohen fjalët "dhe anëtarët e familjes së shtetasve të njërit prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe të zonës Shengen që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë".

2. Pas shkronjës "a" shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:

"a/1) shtetas të njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;".

3. Në shkronjën "b", nënndarja "iii", fjalët "të anijeve apo" hiqen.

4. Pas shkronjës "b" shtohen shkronjat "b/1" dhe "c" me këtë përmbajtje:

"b/1) për qëndrim deri në 2 muaj, brenda 1 viti, të pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve;

c) që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore. Deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti.".

Neni 11

Në nenin 82 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kuotat vjetore për punësimin e të huajve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e migracionit të punës dhe të ministrit përgjegjës të sektorit përkatës.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Kur nevojat e parashikuara për numrin e punëtorëve të huaj për një sektor të caktuar tejkalojnë numrin e përcaktuar në kuotën vjetore, ministri përgjegjës për çështjet e migracionit të punës, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për një sektor të caktuar, i propozojnë Këshillit të Ministrave miratimin e kuotave të reja për atë sektor.".

3. Pikat 3 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

"3. Kuotat vjetore për punësimin e të huajve përcaktohen, duke marrë parasysh analizën e nevojave për aftësi në tregun shqiptar të punës, projeksionet për zhvillimin ekonomik në sektorë të caktuar dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ata sektorë.

6. Procedurat e bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitucional për përcaktimin e kuotave vjetore për punësim miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e migracionit të punës.".

Neni 12

Në nenin 84 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Leja e punës për të huajin si punëmarrës, brenda kuotave vjetore të përcaktuara në nenin 82, të këtij ligji, lëshohet duke mbajtur parasysh nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë.".

2. Në pikën 2, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Autoriteti shtetëror përgjegjës për punësimin, përpara miratimit të kërkesës për leje pune për një shtetas të huaj, propozon, brenda afatit kohor të publikimit të vendit të lirë të punës, kandidatë të përshtatshëm, sipas profilit të kërkuar, të gatshëm të punojnë në vendin vakant të punës si më poshtë:".

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Kërkesa për plotësimin e një vendi të lirë pune bëhet publike nga autoriteti shtetëror përgjegjës për punësim, për një periudhë

kohore prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike, që nga dita e regjistrimit të kërkesës për leje pune për një shtetas të huaj pranë këtij autoriteti.”.

4. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 85, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) është punëmarrës/i vetëpunësuar në fushën e teknologjisë së informacionit.”.

Neni 14

Në nenin 87, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të huajit, me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë, i jepet leje pune si punëmarrës nëse pozicioni i punës që i ofrohet në rajonin gjeografik, ku punëdhënësi i tij ushtron veprimtarinë ekonomike, nuk mund të plotësohet nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 84, të këtij ligji.”.

Neni 15

Në nenin 151, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët e dytë dhe të tretë me këtë përmbajtje:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për pajisjen me vizë elektronike, në zbatim të nenit 22, pika 5, dhe për formatin e aplikimit për vizën elektronike, në zbatim të nenit 24, pika 1, të ligjit.

Ngarkohet ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për lëshimin e vizës elektronike, në zbatim të nenit 25, pika 2, të ligjit.”.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 12.2.2020.

UDHËZIM
Nr. 4, datë 28.2.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 25.11.2010 “MBI KËRKESAT SPECIFIKE TË HIGJIENËS DHE KONTROLLET ZYRTARE PËR PRODUKTET ME ORIGJINË SHTAZORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në kreun II. A, pika 1, germa “b”, e udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010 “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, ndryshohet si më poshtë:

“Vezët magazinohen dhe transportohen deri në shitjen te konsumatori përfundimtar në një temperaturë që preferohet të jetë konstante, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen optimale të vetive higjienike të tyre. Vezët e freskëta duhet të ruhen dhe transportohen në një temperaturë jo më pak se +5°C. Vezët magazinohen në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të arritshme për ekzaminim. Ekzaminimi i vezëve të kryhet gjatë dhe pas magazinimit. Mbahen të dhëna ekzaminimi, në mënyrë që të kontrollohet data e depozitimit të vezëve dhe data e shpërndarjes”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

UDHËZIM
Nr. 6, datë 4.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSAVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikave 5 dhe 9, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë" (Fondi i Ekselencës),

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Studentët shqiptarë të shkëlqyer dhe nëpunësit civilë (në vijim "kandidatët") mund të përfitojnë mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe financimin nga donacione ose të ardhura të tjera nga burime të ligjshme, për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë apo të ciklit të tretë, jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës, në përputhje me vendimin me nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve përpara fillimit të vitit akademik dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë studimeve, ngrihet komisioni përzgjedhës nga ana e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas përbërjes dhe kritereve përzgjedhëse të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Komisioni përzgjedhës i kandidatëve kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues dhe ka në përbërje të tij 7 anëtarë si më poshtë:

a) kryetari (ministri ose personi i deleguar prej tij);

b) katër anëtarë, të cilët janë pjesë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe kanë titull akademik ose gradë shkencore "Doktor";

c) një anëtar, ish-përfitues i Fondit të Ekselencës, i cili ka përfunduar minimalisht studimet e ciklit të dytë;

ç) një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike, në rastet e shqyrtimit të aplikimeve për kategorinë "Nëpunës civil".

3.1 Në rastet kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.

4. Për administrimin e dokumentacionit të aplikimeve në programin e Fondit të Ekselencës dhe për ndjekjen dhe gjurmimin e ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore/nënligjore dhe atyre të parashikuara në aktmarrëveshje, ministri përgjegjës për arsimin formon një Sekretariat Teknik të Programit (STP), të përbërë nga personel administrativ i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Përbërja dhe detyrat e STP përcaktohen me urdhër ministri, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

KREU II
PROCEDURAT E APLIKIMIT

1. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare nga Fondi i Ekselencës kryhet vetëm në formën elektronike në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve.

2. Periudha gjatë së cilës kryhen aplikimet për secilin vit, për të gjitha kategoritë e përfituesve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar, shpallet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Aplikimet e dërguara jashtë afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose vetëm në formë shkresore nuk do të shqyrtohen.

4. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të dytë (viti i parë), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit *online*, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" (kopje e njehsuar me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të tretë "Doktoratë" (viti i parë) kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit online, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin).

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe të ciklit të dytë "Master" (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare nga nëpunësit civilë të cilët janë pranuar në një program "Master" të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare (njëvjeçare), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit online, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopja e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe/ose të ciklit të dytë "Master" (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Dokumentet e paraqitura në ministrinë përgjegjëse për arsimin, duhet të jenë në gjuhë shqipe ose në gjuhë angleze, origjinale ose të njehsuara me origjinalin. Dokumentacioni në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe dhe angleze duhet të paraqitet i përkthyer dhe i njehsuar me origjinalin nga përkthyes të licencuar.

8. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për studentët të cilët janë mbështetur nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për vitin e dytë e në vijim të studimeve vetëm në ciklin që nuk e kanë përfunduar ende, kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të

Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve, të financuar nga Fondi i Ekselencës (origjinale ose kopje e njehsuar);

ii. dokumentacioni justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm.

KREU III
PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Ministria përgjegjëse për arsimin sipas procedurës si më poshtë:

a) shpall hapjen e programit të fondit të ekselencës dhe afatet e aplikimit;

b) STP-ja njofton kandidatët me e-mail, për mbërritjen e aplikimit dhe për dokumentet shtesë që mund të duhen;

c) STP-ja pasi bën verifikimin e dokumentacionit, informon ministrin/komisionin përzgjedhës për numrin e aplikantëve dhe fushat ku ata kanë aplikuar;

ç) STP-ja vendos në dispozicion të komisionit përzgjedhës gjithë dokumentacionin e depozituar dhe e asiston teknikisht atë gjatë procesit të përzgjedhjes;

d) aplikimet e depozituara në secilin prej muajve të periudhës së aplikimeve të shpallur nga ministria përgjegjëse për arsimin, shqyrtohen nga komisioni përzgjedhës gjatë muajit vijues.

1.1 Fazat e përzgjedhjes:

a) STP-ja bën një vlerësim paraprak për plotësimin e kritereve të parashikuar në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe në këtë udhëzim, nga të gjithë kandidatët, duke përfshirë kandidatët që kanë përfituar mbështetje nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për vitin e dytë e në vijim të studimeve;

b) vlerësimi paraprak së bashku me dosjet e kandidatëve i kalon për shqyrtim komisionit i cili bën vlerësimin për çdo aplikant;

c) pas këtij vlerësimi, Komisioni merr vendimin për kandidatët që përfitojnë mbështetje nga Fondi i Ekselencës. Ky vendim zbardhet në procesverbalin përkatës në të cilin përcaktohet lista e kandidatëve fitues, si dhe shumat e financimit për secilin prej tyre të cilat janë përllogaritur paraprakisht nga STP-ja pasi është marrë informacioni nga drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin mbi masën e fondit në dispozicion;

ç) në rast se pas vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë nga STP-ja, Komisioni nuk arrin të krijojë bindje për një ose më shumë prej kandidatëve, ai mund të kërkojë kryerjen e verifikimeve dhe kërkimin e informacioneve shtesë nga STP-ja ose mund të kërkojë intervistimin e kandidatit/kandidatëve përkatës (vetëm për kandidatët e rinj që aplikojnë për mbështetjen e vitit të parë dhe nuk janë mbështetur më parë nga Fondi i Ekselencës);

d) në rast se Komisioni ka vendosur intervistimin e një ose më shumë kandidatëve, STP-ja njofton përmes e-mail-it kandidatët që janë përzgjedhur për t'u intervistuar për datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave. Komisioni kryen intervistën me kandidatët përkatës dhe në përfundim të saj merr vendimin përfundimtar për këta kandidatë. Intervista kryhet në prezencë të kandidatit ose në rrugë telematike kur ai ndodhet jashtë vendit;

e) vendimet (procesverbalet e mbledhjes) e Komisionit i bashkëlidhen urdhrit të ministrit për shpalljen e kandidatëve fitues ku është parashikuar dhe masa e bursës së akorduar secilit prej tyre.

1.2 Shpallja e kandidatëve fitues:

a) lista e emrave me kandidatët fitues duke përfshirë të dhënat mbi programin e studimit, institucionin e arsimit të lartë, renditjen sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, si dhe masën e financimit, bëhet publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) kandidatët njoftohen, përmes e-mail-it, për klasifikimin e tyre si fitues ose jofitues.

1.3 Lidhja e marrëveshjes:

a) ministria përgjegjëse për arsimin njofton kandidatët fitues për afatin për lidhjen e aktmarrëveshjes;

b) kandidatët fitues nënshkruajnë aktmarrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në emër të ministrisë përgjegjëse për arsimin nënshkruan Sekretari i Përgjithshëm i saj.

Nëse kandidati nuk mund të paraqitet personalisht, për nënshkrimin e aktmarrëveshjes autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër që nënshkruan aktmarrëveshjen në emër të kandidatit;

c) për zbatimin e aktmarrëveshjes ngarkohet drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin, si përgjegjëse për veprimet financiare që bëhen me përfituesit e bursës.

1.4 Likuidimi i pagesës:

Kur kandidati shpallet fitues, shuma e miratuar me urdhër ministri paguhet në llogarinë e përfituesit pranë një banke të nivelit të dytë në valutën e kërkuar.

2. Përfundimi i studimeve

a) me përfundimin e kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, përfundon edhe mbështetja financiare në kuadër të këtij programi;

b) kandidatët mund të vazhdojnë studimet pa u financuar nga Fondi i Ekselencës deri në 1 (një) vit pas përfundimit të kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, pas së cilës nuk do të konsiderohen më pjesë e këtij programi;

c) përfituesit e mbështetjes nga Fondi i Ekselencës dorëzojnë në STP një kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës master dhe listës së notave (dhe temës së diplomës nëse ka pasur të tillë), ose të diplomës së doktoratës dhe të disertacionit, dokumentacionin justifikues të shpenzimeve financiare, si dhe një Jetëshkrim të hollësishëm, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i studimeve.

3. Programi "Alumni – Ekselencat"

Të gjithë përfituesit nga Fondi i Ekselencës, pas përfundimit të studimeve "master", do të bëhen anëtarë të Programit "Alumni – Ekselencat", i cili synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej kontaktet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe përfituesve nga Fondi i Ekselencës.

KREU IV
KRITERET PËR PËRFITIMIN E FINANCIMIT

I. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të dytë jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë, për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Studentët që aplikojnë për t'u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë arritur mesataren e notave mbi 8, për vitin pararendës të studimeve dhe të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike. Për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë "Bachelor" jashtë vendit, konvertimi i mesatares në sistemin shqiptar të vlerësimit, kryhet nga Komisioni Përzgjedhës, bazuar në precedentët e viteve të mëparshëm dhe në informacionin mbi sistemin përkatës të vlerësimit të vendit ku janë kryer studimet e ciklit të parë "Bachelor".

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimit;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

II. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të tretë "Doktoratë jashtë vendit"

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që ndjekin jashtë vendit studimet e plota të doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare, për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Studentët që aplikojnë për t'u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të vitit pararendës.

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) shpenzimeve të jetesës në masën jo më shumë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/muaj për kohëzgjatjen e vitit akademik;

b) shpenzimet e një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

III. Bursa të posaçme, për nëpunësit civilë që kryejnë studimet "Master" të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që i përkasin kategorisë nëpunës civilë që ndjekin jashtë vendit një program 1 (një) – vjeçar "Master" të ciklit të dytë apo të tretë janë përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimeve;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

KREU V
NDËRPRERJA E FINANCIMIT/KTHIMI I MASËS SË BURSËS SË AKORDUAR

1. Ndërprerja e financimit për bursat e parashikuara më sipër, bëhet në rastet e mëposhtme:

a) kur studenti i ciklit të dytë ndërpret studimet për më shumë se 3 (tre) muaj, gjatë vitit akademik përkatës, përjashtuar rastet e sëmundjeve, të vërtetuara nga autoritetet mjekësore apo në raste fatkeqësish familjare dhe forcës madhore;

b) kur studenti nuk jep të gjitha provimet apo e përfundon vitin akademik me notën mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglosakson B);

c) kur studenti nuk plotëson gjithë detyrimet akademike të parashikuara nga institucioni i arsimit të lartë për vitin përkatës, duke konsideruar kohëzgjatjen normale minimale të programit përkatës;

ç) kur studenti nuk aplikon në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Detyrimi për të kthyer masën e bursës së përfituar:

a) përjashtohet nga universiteti pritës;

b) ndërpret studimet për të cilat është mbështetur financiarisht;

c) kur pas përfundimit të studimeve nuk ka shlyer detyrimin e punësimit në Shqipëri, sipas kushteve të parashikuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar;

ç) nuk kanë përmbyllur apo përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti akademik pas përfundimit të afatit zyrtar të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të vërtetuara, të rasteve të fatkeqësive familjare, forcës madhore apo kur parashikohet nga universiteti pritës.

3. Detyrimi dhe modaliteti i punësimit në Republikën e Shqipërisë pas përfundimit të studimeve të financuara nga Fondi i Ekselencës, përcaktohet në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

4. Studentët, që kanë përfituar bursë dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, në këtë udhëzim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur midis përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar në formë burse nga Fondi i Ekselencës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, do të ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 16, datë 1.8.2014, "Për përcaktimin e kritereve, masës së financimit dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës, Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

SHTOJCË 1
PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.).

b) informacioni akademik (universiteti i studimeve pararendëse, kohëzgjatja e studimeve pararendëse, universiteti ku është pranuar, emërtimi i plotë programit të studimit, kohëzgjatja zyrtare, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin I të studimeve, renditja e universitetit sipas Times Higher Education, masa totale e financimit të kërkuar);

c) deklarata që nuk përfiton apo nuk ka përfituar në të kaluarën ndonjë bursë apo financim tjetër nga shteti shqiptar;

d) deklarata që autorizon ministrinë përgjegjëse për arsimin, për trajtimin dhe përpunimin e të dhënave personale të aplikantit, si dhe publikimin eventual të të gjitha të dhënave që kanë lidhje me studimet e financuara nga Fondi i Ekselencës.

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas Times Higher Education (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" (për të gjitha kategoritë) dhe e ciklit të dytë për kandidatët që do të ndjekin studimet e doktoratës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

c) vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

d) CV-ja e kandidatit;

e) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në marrjen e informacionit zyrtar nga Universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

f) deklaratën noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi. (dërgohet edhe me postë);

g) në rast bashkëfinancimi ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose te huaja të paraqitet dokumentacioni që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përjashtuar ato shtetërore);

h) projektidea e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht objekti kryesor i studimit dhe metodologjia (vetëm për studentët e Doktoratës);

i) miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi (vetëm për nëpunësit civilë).

SHTOJCË 2
PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR STUDENTËT E NDËRMJETËM

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.);

b) informacioni akademik (universiteti ku është financuar nga Fondi i Ekselencës vitin e mëparshëm, emërtimi i plotë programit të studimit, viti i studimit të përfunduar, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin e ardhshëm të studimeve).

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve të financuar nga Fondi i Ekselencës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve akademike për vitin pararendës;

c) vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë për periudhën e qëndrimit dhe frekuentimit të institucionit ku ndiqen studimet (vetëm për studentët e Doktoratës);

d) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin në marrjen e informacionit zyrtar nga universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

e) një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jofinanciare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

f) dokumentacion justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë).

SHTOJCË 3

AUTHORISATION LETTER

I, _____ hereby authorise the Ministry of Education, Sports and Youth of Albania to enquire/ retrieve any information regarding my studies at _____

I also authorise the release of any information to the above Institution for verification purposes.

Full name: _____ University: _____

Signature: _____ Date: _____

SHTOJCË 4

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruar _____ i/e datëlindjes _____,
(emër atësi mbiemër) (datë/muaj/vit)

aplikant/kërkues i mbështetjes financiare nga programi i Fondit të Ekselencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për kryerjen e studimeve jashtë vendit,

Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se të gjitha të dhënat që kam plotësuar në formularin e aplikimit në programin e Fondit të Ekselencës me nr. reference: _____ janë të sakta dhe të vërteta.

Deklaruesi

_____
(emër atësi mbiemër nënshkrimi) Datë ____ / ___/_____

SHTOJCË 5

EMBLEMA E INSTITUCIONIT

Nr. _____ prot.Tiranë, më ___.___._____

AUTORIZIM

Autorizoj Z/znj. _____, të aplikojë në programin e Fondit të Ekselencës, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për mbështetje financiare për kryerjen e studimeve master, në fushën e _____ në universitetin _____.

Titullari i institucionit

Firma

Vula

VENDIM
Nr. 78, datë 4.3.2020

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN "PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM TË PROKURORËVE", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 64, DATË 15.4.2019, TË KLP-së

Në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 59, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 164 dhe 189, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Pika 3, e nenit 3, të rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", shfuqizohet.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

VENDIM
Nr. 120, datë 5.3.2020

PËR MIRATIMIN E "FORMULARIT TË INTEGRUAR TË VLERËSIMIT TË GJYQTARIT"

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, nenet 2, 68–72, 74–78, 84–95, 97 dhe 171, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 "Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve" dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 264, datë 19.12.2019 "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

VENDOSI:

1. Miratimin e "Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit", sipas formatit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. "Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit" hartohet në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

FORMULAR I INTEGRUAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT

Për periudhën 20__ - 20 ___

TË DHËNAT E GJYQTARIT	TË DHËNAT E KRYETARIT
Emri:	**Emri:**
Mbiemri:	**Mbiemri:**
Datëlindja:	**Datëlindja:**
Vendbanimi:	**Vendbanimi:**
Adresa e e-mail-it zyrtar:	**Adresa e e-mail-it zyrtar:**
Adresa e e-mail-it privat:	**Adresa e e-mail-it privat:**
Numër telefoni:	**Numër telefoni:**
Gjykata:	**Gjykata:**
Funksioni:	**Funksioni:**

Formulari i integruar i vlerësimit dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky formular vlerësimi ka të integruar në përmbajtjen e tij vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe mendimin përfundimtar të Kryetarit, prandaj titullohet "Formular i integruar i vlerësimit të gjyqtarit".

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronjat "ç" dhe "d", të ligjit për statusin.

3. Formulari i integruar i vlerësimit, plotësohet nga gjyqtari në zbatim të nenit 86, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (ligji për statusin) dhe nga Kryetari, në rubrikat përkatëse, në zbatim të nenit 87, të ligjit për statusin.

4. Gjyqtari plotëson formularin e vlerësimit, në rubrikat përkatëse të caktuara për të dhe ia dorëzon kryetarit të gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

5. Kryetari i gjykatës, ku gjyqtari ka ushtruar detyrën gjatë periudhës së vlerësimit, jep mendimin paraprak, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar "Mendimi paraprak i Kryetarit" dhe ia njofton atë gjyqtarit, jo më vonë se katër javë nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit paraprak, gjyqtari mund të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin.

6. Pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin sipas procedurës së parashikuar në nenin 87, të ligjit për statusin, Kryetari jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e gjyqtarit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar "Mendimi përfundimtar i Kryetarit".

7. Në rast se në momentin e fillimit të procesit të vlerësimit etik-profesional, kompetencat e Kryetarit ushtrohen nga zëvendëskryetari, në referim të parashikimeve të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", formulari i mendimit

përfundimtar të kryetarit plotësohet nga zëvendëskryetari.

8. Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari që vlerësohet, ka ushtruar detyrën në më shumë se një gjykatë, formulari i integruar i vlerësimit plotësohet nga gjyqtari dhe kryetari i secilës gjykatë, për periudhën përkatëse.

9. Në rastin kur gjyqtari që vlerësohet ushtron funksionet e kryetarit të gjykatës, formulari i integruar i vlerësimit, plotësohet nga gjyqtari vetëm për rubrikat e vetëvlerësimit, ndërsa rubrikat e "mendimit të kryetarit" mbeten të paplotësuara.

10. Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit përmban, veç mendimit të kryetarit (paraprak dhe përfundimtar), edhe kundërshtimet e mundshme të gjyqtarit për secilin nga kriteret, aspektet dhe treguesit e vlerësimit.

11. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga gjyqtari dhe kryetari.

12. Formularit i bashkëngjiten dy vendime të përzgjedhura prej gjyqtarit për secilin vit vlerësimi, si dhe dokumente që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale. Dokumentet për trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

13. Pas realizimit të procedurës së parashikuar nga neni 87 i ligjit për statusin, por jo më vonë se 2 muaj nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarit, kryetari dërgon pranë Këshillit në format elektronik dhe shkresor, formularin e integruar të vlerësimit të gjyqtarit bashkë me aktet e vlerësimit të përcaktuara në nenin 88 pika 2 të ligjit për statusin.

Vetëvlerësimi i gjyqtarit në zbatim të nenit 86 të ligjit për statusin.

14. Gjyqtari vetëvlerësohet sipas katër grup kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi.

15. Gjyqtari bën vetëvlerësimin e aftësive organizative duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi mbi bazën e një analize të pavarur të të dhënave të tij statistikore, referuar tabelave statistikore që i janë vënë në dispozicion para fillimit të procesit të vlerësimit.

16. Gjyqtari ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij. Në pjesët e formularit dedikuar shpjegimeve, gjyqtari parashtron të dhënat, kushtet faktike dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

Mendimi i kryetarit, në zbatim të nenit 87, pika 1, të ligjit për statusin, bazohet në standardet e mëposhtme:

17. Kryetari nuk jep mendim për kriterin e aftësisë profesionale të gjyqtarit.

18. Në mendimin e kryetarit përshkruhet dhe vlerësohet veprimtaria e gjyqtarit sipas tri grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, konkretisht për:

- "Aftësitë organizative";
- "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale"; dhe
- "Aftësitë personale dhe angazhimin profesional".

i. Për kriterin e "Aftësisë organizative" kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin për:

- Aftësinë e përballjes së ngarkesës në punë, e vlerësuar nëpërmjet:

a) respektimit të afateve ligjore;

b) plotësimin e standardeve minimale kohore;

c) kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje;

d) rendimentit të përfundimit të çështjeve;

e) kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar.

- Aftësinë për të kryer procedura gjyqësore, e vlerësuar nëpërmjet:

a) numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive;

b) kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor;

ii. Për kriterin e "Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale", kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin, për:

- etikën në punë të gjyqtarit e vlerësuar nëpërmjet angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion;

- integritetin e gjyqtarit, i vlerësuar nëpërmjet shmangies së shfaqjeve të pahijshme dhe transmetimit nga gjyqtari të vlerave të tilla personale dhe profesionale si nderi dhe dinjiteti;

- paanësisë në funksion, e vlerësuar kjo nëpërmjet "numrit tejet të lartë ose të pakonsiderueshëm" të kërkesave të pranuara për përjashtim gjyqtari;

iii. për kriterin e "Aftësisë personale dhe angazhimit profesionale", kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin për:

- Aftësinë e komunikimit të gjyqtarit e vlerësuar nëpërmjet:

a) komunikimit të qartë dhe transparent;

b) respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

- Aftësinë për të bashkëpunuar, e vlerësuar nëpërmjet:

a) shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta;

b) shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

- Gatishmërinë e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, e vlerësuar nëpërmjet:

a) pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave.

19. Mendimi përfundimtar i kryetarit jepet duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në nenin 78 të ligjit për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Kryetari duhet të japë shpjegime dhe të argumentojë mendimin e tij, veçanërisht për ato kritere për të cilat mendimi i tij përfundimtar, ndryshon nga vëtëvlerësimi i kryer nga gjyqtari.

20. Kryetari vlerëson aftësitë organizative të gjyqtarit duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi, mbi bazën e analizës së të dhënave statistikore të veprimtarisë së gjyqtarit, duke i krahasuar ato me treguesit mesatarë statistikore të gjykatës, për të njëjtën kategori çështjesh, brenda të njëjtit seksion (nëse gjykata ka pasur të tillë), në të njëjtën periudhë kohore.

21. Kryetari jep mendim për treguesin "rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore", duke bërë krahasimin e rendimentit të gjyqtarit, me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues gjatë periudhës së vlerësimit (rendimentin e përfundimit të çështjeve në gjykatë), si dhe krahasimin e numrit total të çështjeve që ka gjykuar ky gjyqtar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të gjykuara në gjykatë.

22. Kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së gjyqtarit në shmangien e seancave gjyqësore joproduktive duke bërë krahasimin jo vetëm me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për numrin mesatar të seancave gjyqësore sipas kategorisë së çështjes, por dhe në referim të përqindjes totale të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari brenda afatit ligjor dhe standardit minimal.

23. Kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së gjyqtarit në organizimin e procesit gjyqësor, bazuar në të dhëna objektivisht të konstatuara prej tij, pa qenë i nevojshëm hulumtimi mbi çdo dosje gjyqësore të gjyqtarit.

24. Kryetari jep mendim për etikën, integritetin dhe paanësinë e gjyqtarit, bazuar mbi prezumimin se gjyqtari i ka këto cilësi. Kryetari parashtron dhe jep mendim për problematika të shfaqura nga gjyqtari, të tilla që duhet të merren parasysh në vlerësim.

25. Kryetari jep mendim nëse numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtim gjyqtari është "tejet i lartë" ose "i pakonsiderueshëm", jo vetëm në aspektin sasior, apo krahasuar me numrin total të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari. Kryetari duhet të marrë në konsideratë numrin e kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari si dhe raportin midis kërkesave për heqje dorë të miratuara me ato të refuzuara. Kryetari jep mendim për këtë tregues, pa analizuar ligjshmërinë ose bazueshmërinë e vendimit të pranimit të kërkesës për përjashtim.

26. Kryetari jep mendim për treguesin e "gatishmërinë e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera" në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit të gjyqtarit, apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Gjykatës.

VLERËSIMI PËRKUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE
1. Vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarit

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1. A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar faktet e çështjes, identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave sipas rastit.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)*

1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin e identifikuar dhe arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi. Vlerësohet gjithashtu aftësia në zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes, aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante vendase dhe ndërkombëtare, referimi dhe menaxhimi me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit në praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-ja dhe gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës po i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)*

1.B Arsyetimi ligjor.

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.
Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐
Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)*				

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të hartuar vendimin sipas një strukture të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar, të cilës gjyqtari i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Në veçanti, vlerësohet ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të vendimit, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së tij.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐
Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)*				

1.B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për kryer një analizë cilësore, mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e gjyqtarit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situate të caktuar. Në veçanti, vlerësohet nëse niveli i arsyetimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor dhe nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)*				

2. Vlerësimi i aftësive organizative të gjyqtarit.

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të organizuar, administruar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore, aftësia e menaxhimit efektiv të kohës si në planifikimin e seancave gjyqësore ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, si dhe aftësia për të administruar dosjen gjyqësore.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A-a Respektimi i afateve ligjore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive. Vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat.

Gjyqtari bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët☐ (mbi 40%)	Nën mesataren☐ (31-40%)	Mesatare☐ (21-30%)	Mbi mesataren☐ (11-20%)	Shumë e lartë☐ (0-10%)

Shpjegime *(Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal)*

Mendimi paraprak i kryetarit (*Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit, Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës gjatë periudhës së vlerësimit, për këtë tregues*)

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesatare☐	Shumë e lartë☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

2.A-b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen afate gjykimi.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët☐ (mbi 40%)	Nën mesataren☐ (mbi 30-40%)	Mesatare☐ (mbi 20-30%)	Mbi mesataren☐ (mbi 10-20%)	Shumë e lartë☐ (0-10%)

Shpjegime (*Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal*)

Mendimi paraprak i kryetarit (*Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës, për këtë tregues)*

E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren☒	Shumë e lartë☐

2.A-c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përfunduar çështjet në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standardet minimale kohore të miratuara, për çdo kategori. Në totalin e çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore gjykimi.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krahasimit me standardet e miratuara.

E dobët☐ (Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve)	Nën mesataren☐ (Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve)	Mesatare☐ (Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve)	Mbi mesataren☐ (Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve)	Shumë e lartë☐ (Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve)
Shpjegime *(Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264 datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal)*				
Mendimi paraprak i kryetarit *(Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës, për këtë tregues)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*				
E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

2.A-ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për përfundimin e çështjeve gjyqësore, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve që i janë caktuar brenda një viti kalendarik.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët☐ (nën 81%)	Nën mesataren☐ (mbi 81–87%)	Mesatare☐ (mbi 87–93%)	Mbi mesataren☐ (mbi 93–99%)	Shumë e lartë☐ (mbi 99%)

Shpjegime (*Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë, referuar "Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës të miratuar.)*

Mendimi paraprak i kryetarit (*Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin e rendimentit të gjyqtarit me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues (rendimenti i gjykatës) si dhe krahasimin e numrit total të çështjeve që ka gjykuar ky gjyqtar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të gjykuara në atë gjykatë)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

2.A-d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore. Treguesi mesatar i kohës së arsyetimit për të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e dorëzimit të vendimit, tregues i cili krahasohet me afatin procedural të parashikuar në ligj.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përcakton shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krahasimit me afatin procedural të parashikuar në ligj.

E dobët☐ (Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve)	Nën mesataren☐ (Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve)	Mesatare☐ (Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve)	Mbi mesataren☐ (Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve)	Shumë e lartë☐ (Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve)

Shpjegime (*Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%)*

Mendimi paraprak i kryetarit (*Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë i lartë☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)
Jo☐
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë i lartë☐

2.B Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore

2.B-a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për kryerjen e procedurave gjyqësore efektive për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse, si dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Vlerësohet eficienca e gjyqtarit për kryerjen e veprimeve të tilla si: mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit; marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse; planifikimi i seancave, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjes, afatet ligjore, dhe mendimin e palëve si dhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave joproduktive.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përcakton numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, nëse kjo e dhënë është pjesë e tabelave statistikore. Ai vetëvlerëson aftësinë në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive dhe përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme të vlerësimit.

(Sipas metodologjisë se miratuar dhe nenit 171, pika 9, e ligjit për statusin, treguesi i numrit mesatar të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, do të identifikohet dhe analizohet nga vlerësuesi vetëm për çështjet e zgjedhura me short)

E dobët☐ Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët aftësie	Mesatare ☐ Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare aftësie	E lartë☐ 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë aftësie
Shpjegime (*Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive)*		
Mendimi paraprak i kryetarit (*Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues. Këtu kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin jo vetëm me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë indikator (për numrin e seancave), por dhe në referim të përqindjes totale të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari brenda afatit ligjor dhe standardit minimal.)*		
E dobët☐	Mesatare☐	E lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?		
Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)		

Jo☐
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Mesatare☐	E lartë☐

2.B-b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë efektiv në kryerjen e veprimeve procedurale të tilla si: vënia në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore; kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes; planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive; dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre; fillimi i seancave pa vonesë; regjistrimi audio i seancave; ndjekja me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor; orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime

Mendimi paraprak i kryetarit *(Si e vlerëson kryetari shkallën e aftësisë së gjyqtarit në organizimin e procesit gjyqësor, bazuar në të dhëna objektivisht të konstatuara prej tij, pa qenë i nevojshëm hulumtimi mbi çdo dosje gjyqësore të gjyqtarit)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C-a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet në bazë të renditjes së akteve të dosjes gjyqësore në mënyrë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime

2.C-b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i duhuri dhe t'i përkasë çështjes konkrete.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë se tij?				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime				

3. Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën më shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.*** ***Si e vlerëson gjyqtari shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?***				
E dobët☐	Nën mesatare☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime				
Mendimi paraprak i kryetarit (*Si e vlerëson kryetari shkallën e angazhimit dhe të përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit?)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

3.B Integriteti i gjyqtarit.

3.B-a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti. ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangja e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti ; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije***

se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Gjatë marrjes së vendimeve, gjyqtarët duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre. Gjyqtarët nuk duhet të tregojnë favor apo disfavor në lidhje me çështjet, palët, ose avokatët, në çështjet përpara gjykatës. Një gjyqtar gëzon nder dhe dinjitet për publikun kur ai transmeton vlera personale dhe profesionale dhe konsiderohet një model për të tjerët.
Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij? *(Prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë integriteti)*

E dobët☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime	
Mendimi paraprak i kryetarit (*Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?*)	
E dobët☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?	
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)	
Jo☐	
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*	
E dobët☐	Shumë e lartë☐

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese				
Me këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykime.				
Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime				

3.C-b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	
Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shfaqur paanësi në funksion. Gjyqtari bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme të vlerësimit, referuar metodologjisë së pikëzimit.	
Si e vlerëson gjyqtari numrin e kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e tij?	
Tejet i lartë☐	I pakonsiderueshëm☐
Shpjegime	
Mendimi paraprak i kryetarit (*Kryetari jep mendim paraprak për këtë tregues bazuar jo vetëm në aspektin sasior, apo krahasuar me numrin total të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari. Kryetari duhet të marrë në konsideratë numrin e kërkesave për*	

heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari si dhe raportin midis kërkesave për heqje dorë të miratuara me ato të refuzuara. Kryetari jep mendim për këtë tregues, pa analizuar ligjshmërinë ose besueshmërinë e vendimit të pranimit të kërkesës për përjashtim). *Si e vlerëson kryetari numrin e kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit?*

Tejet i lartë☐	I pakonsiderueshëm☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?	
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)	
Jo☐	
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*	
Tejet i lartë☐	I pakonsiderueshëm☐

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime				
Mendimi paraprak i kryetarit (*Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?*)				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personal

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të treguar kujdesin maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të

cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit, siç mund të jenë çështjet me të mitur, ato të dhunës në familje etj.   ***Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?***

E dobët☐	Mesatare☐	E lartë☐
Shpjegime		
Mendimi paraprak i kryetarit (*Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?*)		
E dobët☐	Mesatare☐	E lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?		
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)		
Jo☐		
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*		
E dobët☐	Mesatare☐	E lartë☐

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B-a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta. ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje, angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njësuese, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore, si dhe gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përftuar në aktivitetet e ndryshme trajnuese.*** ***Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimin me kolegët?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime				
Mendimi paraprak i kryetarit *(Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimin me kolegët?)*				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				

Jo☐
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

4.B-b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore
Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të ndërvepruar rregullisht me personelin e gjykatës, nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me qëllim krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv.
Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime
Mendimi paraprak i kryetarit *(Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore? Cila është shkalla e këtij komunikimi?)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?
Po☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)
Jo☐
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjer.

4.C-a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.
Me këtë tregues vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, me qëllim ngritjen profesionale të gjyqtarit.
A e ka përmbushur gjyqtari detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, gjatë periudhës së vlerësimit?

Po☐	Jo☐
Shpjegime *(Këtu gjyqtari duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të zhvilluar jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit).*	

4.C-b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve. ***Me këtë tregues vlerësohet gatishmëria dhe shfaqja e vullnetit të gjyqtarit pranë organeve përkatëse me qëllim përfshirjen në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.***
Shpjegime (*Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtaritë trajnuese në të cilat është angazhuar*).

4.C-c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. ***Me këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin gjyqësor, veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e eficiencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.***
Shpjegime *(Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstitucionale si më sipër. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.*)
Mendimi paraprak i kryetarit *(Kryetari jep mendim paraprak për këtë tregues në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit të gjyqtarit, apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Gjykatës)*
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?
Po ☐(nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)
Jo☐
Mendimi përfundimtar i kryetarit *(Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjesës me gjyqtarin)*

4.C-ç Publikime ligjore akademike ***Me anë të këtij treguesi vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës, të tilla si: artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).***
Shpjegime (*Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi publikimet ligjore akademike të tij gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit*)

Në referim të nenit 86, pika 1, shkronjat "c", "ç", "d", "dh" të ligjit për statusin, gjyqtari jep mendim për sa më poshtë:

a) Masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre.

Shpjegime

b) Objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm.

Shpjegime

c) Nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional duke propozuar zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

Shpjegime

Në referim të nenit 86, pika 2, të ligjit për statusin, gjyqtari i bashkëlidh formularit të vetëvlerësimit dy vendime gjyqësore të përzgjedhura prej tij, për çdo vit të periudhës së vlerësimit.

a) Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari.

Vendimet e përzgjedhura listohen në këtë rubrikë dhe i bashkëlidhen formularit të vlerësimit.

<u>Për t'u plotësuar nga gjyqtari</u>

Plotësuar nga: Emër: Mbiemër:Nënshkrimi:

Dorëzuar te Kryetari më datë:

Marrë në dorëzim nga:Emër:Mbiemër:Nënshkrimi:

<u>Për t'u plotësuar nga kryetari</u>

Plotësuar nga: Emër: Mbiemër:

Nënshkrimi:

VENDIM
Nr. 126, datë 6.3.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 30, DATË 14.2.2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 3, të nenit 4, në pikën 1, të nenit 147, si dhe në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2, 89, 97 dhe 98, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.2.2019, "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", bëhen këto shtesa:

Pas paragrafit X/1, shtohet paragrafi X/2 me këtë përmbajtje:

"X/2 Dispozitë për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar

1. Ky vendim zbatohet edhe për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

KËRKESË
Nr. 2551, datë 6.3.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte në fshatin Mbrakull", Poliçan.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Poliçan.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,664,617 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli

Lista e shpronësimit të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i segmëntit rrugor "Komuna e Parisit-Rrugë e Re Tiranë- Elbasan "(shtesa)"Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte në fshatin Mbrakull", Poliçan

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/ pasurisë	Sipërfaqja totale (m^2)	Sipërfaqe shpronësimi			Çmimi (lekë)		Vlera e tokës Arë (lekë)	Vlera e tokës Truall (Arë)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale / Lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga nga ZVRPP-ja
					Tokë Arë (m^2)	Tokë Truall (m^2)	Sip. Ndërtese (m^2)	Tokë Arë/m^2	Tokë Truall /m^2					
1	Kosta Ilias Mile	2632	100/16	500	250	250	80	203	189	50750	47250	1,566,617.00	1,664,617.00	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale e shpronësimit													**1,664,617.00**	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 131(823), datë 6.2.2020, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Petroshi, i datëlindjes 1988, banues në fshatin Shelcan, rrethi Elbasan, dhe vendosi të caktojë kërkuesin Kostandin Petroshi me cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasja Rafije Qefa kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të vdekur të shtetasit Ymer Qafa, lindur në Sallbeg-Durrës, më datë 17.4.1951, dhe banues në Lushnjë.

KËRKUESE
Refije Qefa

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë